

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6745
E hënë, 31 tetor 2022
çmimi 0.40

Veriu i Kosovës i qetë,
"masat e qortimit" nisin
më 1 nëntor

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

Nisma Socialdemokrate ka mbajtur konventë politike

LIMAJ BËN THIRRJE PËR NJË FRONT TË PËRBASHKËT DEMOKRATIK



Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka theksuar se nga 14 shkurti Kosova ka marrë një drejtim pa krye, duke u ndikuar nga njerëz të padëshmuar, me premtime boshe, shpifje e mashtrime, që për mision kanë mohimin e shtetit të Kosovës dhe çdo gjeje që është bërë në këtë vend në

kohë lirie e shtetndërtimi. Në konventën politike të prezantuar nga kjo parti, Limaj ka bërë thirrje për një front të përbashkët demokratik. "Bëjmë thirrje për një front të përbashkët demokratik për t'i thënë jo edhe më tej rrënimit që po i bëhet shtetit të Kosovës nga kjo elitë mohuese", ka thënë Limaj

AKTUALE



MBI 153 TË VDEKUR NË KORENË E
JUGUT PËR HALLOWEEN F. 2

UKRAINA DHE RUSIA KËMBEJNË
PËRSËRI TË BURGOSURIT F. 2

HARADINAJ: BASHKATDHETARËT
DHANË MBËSHËTJEJE PËR KOSOVËN
NË ÇASTE TË RËNDËSISHME F. 3

EKONOMI



BUXHETI I VITIT 2023 DO TË JETË
3.2 MILIARDË EURO F. 7

RRITJA E ÇMIMEVE VAZHDON TË
JETË SHOQËTËSIMI KRYESOR PËR
GJERMANËT F. 7

SPORT



PEJA NUK NJEH HUMBJE, YLLI SHIJON
FITOREN E KATËRT RADHAZI F. 24



**GRUBI: PRISHTINA,
TIRANA DHE
SHKUPI DUHET
TË KOORDINOHEN
SHUMË MË
TEPËR PËR
MBROJTJE TË
VLERAVE TË UÇK-së**

FAQE 3



**ARRESTOHEN TRE
PERSONA, SEKUESTROHET
DROGË DHE PARA**

FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina dhe Rusia këmbajnë përsëri të burgosurit

KIEV, 30 TETOR - Ukraina dhe Rusia kanë kryer një tjetër këmbim të të burgosurve, tha më 29 tetor shef i Zyrës së presidentit ukrainas, Andriy Yermak. Sipas tij, aksioni rezultoi me lirim të 52 shtetasve ukrainas. Ai tha se të përfshirë në këmbim janë "oficerë, mjekë, rreshterë dhe ushtarë". Denis Pushilin, administrator i territorit që e

quan veten Republika Popullore e Donjeckut, tha se 50 persona nga secila palë u këmben. Ministria ruse e Mbrojtjes ka njoftuar se 50 ushtarakë u kthyen, duke shtuar se ata ishin "në rrezik vdekjeprurës në robëri". Ata do të dërgohen në Moskë nga ushtria ruse për trajtim dhe rehabilitim, ka njoftuar kjo ministri.

Edhe më 11 tetor Ukraina tha se 32 ushtarë të saj janë liruar në kuadër të këmbimit të të burgosurve me Rusinë. Rusia dhe Ukraina kanë këmbyer një numër të madh të të burgosurve të luftës - pothuajse 300 persona më 21 shtator. Ky është këmbimi më i madh të burgosurve që nga nisja e luftës. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.



Mbi 153 të vdekur në Korenë e Jugut për Halloween

SEUL, 30 TETOR - Ka shkuar në 153 numri i personave që kanë vdekur nga shtypjet gjatë natës së festimit të Halloweenit (Natës së Shtrigave) në kryeqytetin e Koresë së Jugut, Seul, ndërsa 133 të tjerë janë plagosur, 37 prej tyre pësuan lëndime të rënda. Mes të vdekurve janë edhe 20 shtetas të huaj, thonë shërbimet e urgjencës në Seul, raporton BBC.

Incidenti vdekjeprurës i 30 tetorit, i cili raportohet se ka nisur pas orës 22:00 me orën lokale, ndodhi në Itaewon - një zonë e njohur e jetës së natës - në festimin e parë të Halloweenit që nga pandemia e koronavirusit.

Policia koreane thotë se 141 nga 153 personat e vdekur janë identifikuar dhe familjet e tyre janë njoftuar, raporton agjencia koreano-jugore e lajmeve "Yonhap".

Pamjet e një nate më parë nga Seuli shfaqin dhjetëra kufoma të mbuluara, zyrtarë të



emergjencës që intervenojnë të të lënduarit dhe njerëz që ndihmojnë njëri-tjetrin për të

shpëtuar nga shtypja. Raportohet se kishte paralajmërim se rrugët do të

ishin të mbushura me njerëz, por ende nuk dihet se si filloi përplasja e turmës.

Aktori Park Jung-hoon tha se turmat ishin "disa dhjetëra herë më të mëdha" se në Krishtlindje ose gjatë shfaqjeve të fishekzjarrëve.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka shkruar në "Twitter" se ndihet i pikëlluar për atë që ndodhi në Seul. "Ngushëllimet tona më të thella për familjarët dhe miqtë e të vdekurve dhe të plagosurve", ka shkruar ai.

Edhe presidenti francez, Emmanuel Macron, ka shprehur ngushëllimet e tij për popullin korean.

"Franca është me ju", ka shkruar ai në "Twitter".

Lideri kinez Xi Jinping i ka dërguar një mesazh homologut të tij të Koresë së Jugut, Yoon Suk-yeol, duke u shprehur ngushëllime familjeve të viktimave, raporton media shtetërore kineze CCTV. Ai tha se në këtë fatkeqësi kanë humbur jetën katër kinezë dhe dy të tjerë janë lënduar.

ShBA-ja kritikon Rusinë për pezullimin e marrëveshjes për eksportin e grurit

UASHINGTON, 30 TETOR - Shtetet e Bashkuara kanë kritikuar ashpër Rusinë për pezullimin e marrëveshjes së ndërmjetësuar nga OKB-ja për ta lehtësuar eksportin e drithit ukrainas përmes Detit të Zi, duke thënë se Moska po e përdorë krizën ushqimore si armë në luftë. Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, i kërkoi Moskës më 30 tetor që "ta rifillojë pjesëmarrjen e saj në iniciativë", duke shtuar se që nga fundi i korrikut marrëveshja kishte mundësuar eksportin e më shumë se nëntë milionëve tonë drithërave, gjë që ka bërë të "ulen çmimet në mbarë botën dhe ka qenë jashtëzakonisht e rëndësishme sidomos për vendet me të ardhura të

ulëta dhe të mesme". Rusia njoftoi sekretarin e përgjithshëm të OKB-së, Antonio Guterres, më 29 tetor, se ka pezulluar marrëveshjen, me arsyetimin se nuk mund ta "garantonte sigurinë e anijeve civile" që udhëtonin sipas paktit. Moska përmendi gjithashtu "sulmet terroriste" kundër flotës së saj në Detin e Zi pranë rajonit të okupuar ukrainas të Krimesë, si një arsye për pezullimin e programit ushqimor. Në të njëjtën ditë, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky bëri thirrje që Rusia të përjashtohet nga Grupi i 20 ekonomive kryesore globale (G20). Edhe Kombet e Bashkuara kanë kërkuar që e

marrëveshja për eksportin e grurit mes Ukrainës dhe Rusisë, e cila ishte ndërmjetësuar nga OKB-ja dhe Turqia, të vazhdohet. Marrëveshja fillestare ishte caktuar të zgjaste 120 ditë, me opsionin për ripërtëritje më 19 nëntor "nëse asnjë palë nuk kundërshton", tha zëdhënësi i OKB-së, Stephane Dujarric, në një deklaratë më 28 tetor. Marrëveshja çliroi eksportet nga tri portet e Ukrainës, Odesa, Chornomorsk dhe Yuzhne, të cilat ishin bllokuar qëkur Rusia nisi pushtimin e Ukrainës në fund të shkurtit. Me këtë marrëveshje u lejua që afro nëntë milionë tonë drithë të largoheshin nga këto tri porte. Rusia dhe Ukraina janë të dyja furnizuese kyçe të



drithërave, dhe konflikti i vazhdueshëm vetëm ka vënë në pah brishtësinë e zinxhirit global të furnizimit me ushqime, kur dy shtetet kryesore janë jashtë tregut. Më 2021 Rusia dhe Ukraina janë renditur si lidere globale në eksport të elbit, misrit, luleve të verdha për vajra,

farave të lulediellit dhe vajit të lulediellit.

Së bashku ato eksportojnë pothuajse 30 për qind të furnizimeve me grurë në botë. Rusia eksporton 17 për qind të grurit në nivel botëror, ndërsa Ukraina rreth 20 për qind të luleve të verdha për vajra.

Veriu i Kosovës i qetë, “masat e qortimit” nisin më 1 nëntor

PRISHTINË, 30 TETOR - Dy ditë para se të nisë zbatimi i “masave qortuese”, sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës për targa, situata në veriun e Mitrovicë është e qetë. Qytetarët serbë në përgjithësi po e kundërshtojnë ndërrimin e targave nga ato KM në RKS, derisa autoritetet e Kosovës janë të vendosura për ta filluar zbatimin e vendimeve. Besim Hoti, zëvendës drejtor i policisë rajonale në veriun e vendit, ka thënë të dielën se situata përgjithësisht është stabile. Ndërkaq udhëheqësja e Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve në Mitrovicë të Veriut, Ardita Ademi, ka thënë se të hënën do t'i marrin informacionet e sakta për mënyrën se si do të veprohet nga 1 nëntor kur hyn në fuqi zbatimi i masës qortuese. Në këtë qendër nuk e dinë se çka nënkupton “masa ndëshkimore”.

Qeveria e Kosovës ka shkallëzuar vendimin për targa. Duke filluar nga 1 nëntor deri më 21 nëntor masa

do të jetë ajo e qortimit, pastaj nga 21 nëntori për dy muaj, deri më 21 janar, do të jetë masa e gjobitjes, më pastaj nga 21 janari do të ketë targa provuese për dy muaj të tjerë, pas së cilës datë më 21 prill nuk mund të ketë më targa ilegale në qarkullim.

Bashkimi Evropian nëpërmjet një komunikate për medie shprehu zhgënjimin pasi Qeveria e Kosovës nuk dëgjoji këshillat e bllokut dhe të Shteteve të Bashkuara për zgjatjen e afatit për konvertimin e targave të makinave të lëshuara nga Serbia me ato të Kosovës për 10 muaj.

Në reagimin e BE-së thuhet se Kosova ka të drejtë t'i heqë gradualisht targa e vjetra, “por procesi duhet të zhvillohet në mënyrën e dakorduar në dialog dhe të zbatohet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe konsultative”.

Pavarësisht prej kritikave që kanë ardhur dhe sot nga politikanë vendorë e ndërkombëtarë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka



konsideruar të ligjshëm vendimin për targa ilegale në veri. Ai thotë se vendimi është në përputhje të plotë me Marrëveshjen e Brukselit dhe në harmoni me qëndrimet e bashkësisë ndërkombëtare për rend e ligj, raporton RTK. “Qeveria miratoi zbatimin

gradual të politikës për targa ilegale të shpallura në qershor, për të cilën partnerët tanë ndërkombëtarë konfirmojnë se është plotësisht në përputhje me marrëveshjen e Brukselit. Vendimi i zbatimit garanton sundimin e ligjit nga njëra anë dhe paqen dhe sigurinë nga

ana tjetër”, ka thënë Kurti. Edhe zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Ned Price, ka thënë se Shtetet e Bashkuara, krahas partnerëve ndërkombëtarë, kanë kërkuar që të zgjatet perioda e zbatimit të regjimit të ri të targave për 10 muaj.

Grubi: Prishtina, Tirana dhe Shkupi duhet të koordinohen shumë më tepër në mbrojtje të vlerave të UÇK-së



PRISHTINË, 30 TETOR - Zëvendëskryeministri i parë në Maqedoninë e Veriut, Artan Grubi, vlerëson se Kosova duhet ta marrë shembullin e shtetit të tij për mbylljen e çështjeve të hapura dhe rrugën për të ardhmen evropiane. Sipas tij, nuk ka zgjidhje tjetër përveç njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Serbia, derisa shton që ky është përfundimi të cilin e mbështet dhe e pranon Maqedonia e Veriut.

Në një intervistë për “KosovaPress”, ndër të tjera, Grubi flet edhe për nismën e kryeministrit të Shqipërisë që lidhet me akuzat ndaj ish-krerëve të UÇK-së si dhe ndikimin e Rusisë në Maqedoninë e Veriut. Grubi thotë se duhet marrë

shembull Maqedonia e Veriut në çështjen që kishte me Greqinë dhe Bullgarinë, zgjidhja e të cilave i hapi rrugë vendit drejt Bashkimit Evropian.

Numri dy në Maqedoninë e Veriut thotë se Prishtina, Tirana dhe Shkupi duhet të koordinohen më shumë në politikën e jashtme madje, sipas tij, janë vonuar në këto përpjekje. Këtu ai përmend edhe nismën e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, në kërkesën e tij për t'i hedhur poshtë akuzat për trafikim të organeve, të cilat janë miratuar disa vjet më parë në Këshillin e Evropës në kuadër të raportit të Dick Martyt. “Prishtina, Tirana dhe Shkupi duhet të koordinohen shumë më tepër në politikën e jashtme, në veçanti në mbrojtje të vlerave të

luftës çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe të përpjekjeve të gjithë shqiptarëve në Evropën Juglindore, për liri, drejtësi, barazi, dhe pavarësi në Kosovë si dhe njohje reciproke midis Kosovës dhe Serbisë. Ky bashkërendim i aktiviteteve tona është domosdoshmëri dhe vlerësoj se jemi vonë në këto përpjekje dhe do ta kisha mbështetur iniciativën qoftë ajo të vijë nga kryeministri Kurti apo kryeministri Rama, ndërsa neve na kanë mbështetur gjithmonë. Asnjë e keqe Kosovës nuk mund t'i vijë nga Shkupi apo Tirana, përkundrazi do ta ketë mbështetur absolute në çfarëdo qoftë nisme rajonale, kontinentale apo globale”, thotë zëvendëskryeministri Grubi.

Haradinaj: Bashkatdhetarët dhanë mbështetje për Kosovën në momente të rëndësishme

Vjenë, 30 tetor - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, gjatë një takimi në Vjenë me bashkatdhetarë, ka shpjeguar proceset në të cilat po kalon vendi, krizën ekonomike dhe energjetike që ka kapluar Kosovën, duke vënë në pah edhe një herë

rolin e tyre në forcimin e konsolidimit të shtetit. “Edhe në takimin me biznesmenët shqiptarë në Vjenë shtrova nevojën që mërgata jonë ta shohë Kosovën edhe si vend ku mund të zhvillojnë biznese dhe të investojnë. Motrat e vëllezërit tanë që jetojnë jashtë vendit, janë edhe

partnerët tanë në zhvillim, e Kosova e fortë fuqizon edhe më shumë njerëzit e saj në mbarë botën”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”. Haradinaj gjatë kësaj vizite në Vjenë ka ndarë medaljen “Me besim në Zot, atdhe e shtet” për aktivistët e dalluar të AAK-së.





Nisma Socialdemokrate ka mbajtur konventë politike

Limaj bën thirrje për një front të përbashkët demokratik

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka theksuar se nga 14 shkurti Kosova ka marrë një drejtim pa krye, duke u ndikuar nga njerëz të padëshmuar, me premtime boshe, shpifje dhe mashtrime, që për mision kanë mohimin e shtetit të Kosovës dhe çdo gjeje që është bërë në këtë vend në kohë lirie e shtetndërtimi. Në konventën politike të prezantuar nga kjo parti, Limaj ka bërë thirrje për një front të përbashkët demokratik. “Bëjmë thirrje për një front të përbashkët demokratik për t’i thënë jo edhe më tej rrënimit që po i bëhet shtetit të Kosovës nga kjo elitë mohuese”, ka thënë Limaj

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 TETOR - Nisma Socialdemokrate të dielën, në prani të strukturave drejtuese, ka mbajtur një konventë politike me moton “Veprat flasin”, konventë në të cilën kryetari i këtij subjekti politik, Fatmir Limaj, ka paraqitur para të pranishmëve vizionin politik që do të ndjekin tani e tutje në skenën politike të Kosovës. Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj,

fjalimin e ka hapur me fjalë mirënjohëse për bacën Jakup Krasniqi, duke u lutur për shëndetin e tij dhe duke shprehur bindjen se ata shumë shpejt do t’i kthehen Kosovës. “Veprat flasin - është motoja jonë që shënon edhe rikthimin tonë politik për të bashkuar burra e gra, të rinj e të reja, që punojnë pa ndalur në mënyrë që premtimet që u jepen qytetarëve, t’i kthejmë në vepra edhe më të mëdha për Kosovën”, ka deklaruar Limaj. Ai ka theksuar se nga 14 shkurti

Kosova ka marrë një drejtim pa krye, duke u ndikuar nga njerëz të padëshmuar, me premtime boshe, shpifje e mashtrime, që për mision kanë mohimin e shtetit të Kosovës dhe çdo gjeje që është bërë në këtë vend në kohë lirie dhe shtetndërtimi. “Në krye të shtetit janë ata që e kanë mohuar flamurin, stemën, ata që kanë thënë se Kosova nuk do të ketë ushtri, ata që po vazhdojnë të mohojnë e baltosin çdo gjë që është arritur para se ata të vijnë në krye të shtetit që, fatkeqësisht, janë pa vizion, pa vullnet pozitiv, pa ndonjë të kaluar pozitive që lidhet me vendin tonë. Kosova ka ngecur në zhvillim, ka humbur rrugë, ka humbur partner e ka humbur komunikimin me qytetarët e vet”, është shprehur Limaj, duke bërë thirrje për front të përbashkët demokratik. “Ne si Nismë u bëjmë thirrje të gjithëve për një front të përbashkët demokratik, që bashkon forcat politike, qytetarët, patriotët që janë të gatshëm për t’u bashkuar rreth një platforme politike dhe ekonomike të qartë. Bëjmë thirrje për një

front të përbashkët demokratik, për t’i thënë jo edhe më tej rrënimit që po i bëhet shtetit të Kosovës nga kjo elitë mohuese”, ka thënë ai. Limaj ka treguar se cili duhet të jetë misioni i këtij fronti demokratik. “Ky front i përbashkët demokratik do të ketë për mision hapjen e debatit politik e social, pastaj të shërojë këtë helm që e kanë përhapur një grup njerëzish, përplasjet mes qytetarëve t’i eliminojmë, ta bashkojmë popullin rreth kauzave me interes nacional, ta kthejmë partneritetin me miqtë ndërkombëtarë, t’i rikthejmë marrëdhëniet e mira me shtetin amë, me Tiranën t’i harmonizojmë politikat në çdo sferë, ta rikonfirmojmë identitetin tonë euroatlantik deri në integrimin e plotë në mekanizmat ndërkombëtarë, t’i fuqizojmë raportet me vendet e rajonit për çështje që lidhen me të mirën e rajonit etj”, ka thënë Limaj. Ai ka thënë se qeveria Kurti është duke dëmtuar buxhetin e Kosovës. “Milionë euro për paga, duke qëndruar nëpër zyrtë e duke mos bërë asnjë

punë për Kosovën. Duke qëndruar në zyrë nuk mund të ndërtohen autostrada, nuk mund të ndërtohen shkolla dhe nuk mund të jetësohet asnjë projekt i rëndësishëm për vendin”, ka thënë Limaj, duke shtuar se kreu i qeverisë është duke bërë një angazhim maksimal në funksion të mashtrimit të popullit të Kosovës dhe të partnerëve ndërkombëtarë. “Pa e vrarë mendjen se sa shumë dëm është duke i bërë Kosovës dhe të ardhmes së saj”, ka pohuar Limaj.

Limaj ka thënë se rruga e Kurtit që ka zgjedhur, me logjikë të shpifjes e frikës, është rrugë e kompromiseve të rrezikshme për Kosovën, është rrugë që e fut Kosovën në kahe pa kthim, dhe nëse ai vazhdon me këtë logjikë, Kosova nuk do ta ketë afër as OKB-në, as njohjen nga Serbia. “Nisma është gati që me hapa konkretë të shkojë drejt një fronti të përbashkët demokratik për ta ndryshuar e shpëtuar Kosovën nga kjo qeverisje e mashtrimit, e mohimit të gjithë historisë së shtetndërtimit të Kosovës”, ka theksuar kryetari Limaj.

Edhe BE-ja e “zhgënjyer” me mosshyrjen e afatit për targa

PRISHTINË, 30 TETOR - Bashkimi Evropian tha se është i “zhgënjyer” me vendimin e Qeverisë së Kosovës për mosshyrjen e afatit për reregjistrimin e makinave që kanë targa të lëshuara nga Serbia dhe konvertimin e tyre në targa RKS - Republika e Kosovës. “Është zhgënjyese të shohësh se nuk është ndjekur [këshilla e partnerëve ndërkombëtarë]. Derisa vendimi është një hap në drejtimin e duhur, ai nuk është në përputhje me marrëveshjet e dialogut, të cilat janë të detyrueshme për të dyja palët. Marrëveshja përkatëse e vitit 2016 parashikonte një proces të përcaktuar qartë me një afat kohor 12-mujor për procesin e largimit [të targave], i cili nuk është ndjekur. Kosova duhet të lejojë një periudhë më të gjatë tranzicioni”, u tha në komunikatën e BE-së.

BE-ja tha se është e domosdoshme ruajtja e qetësisë dhe u bëri thirrje palëve që “ta

shmangin çdo veprim apo retorikë që mund ta rrezikojë stabilitetin në terren, veçanërisht në veri të Kosovës”. “Ne presim që palët të angazhohen në mënyrë konstruktive dhe me mirëbesim për të gjetur një zgjidhje pa vonesa të mëtejshme, në përputhje të plotë me marrëveshjet e dialogut”, tha blloku evropian.

Një ditë më parë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës thanë se janë të “zhgënjyera dhe të shqetësuara që Qeveria e Kosovës ka refuzuar kërkesat e partnerëve ndërkombëtarë për ta bërë një gjë të tillë”.

ShBA-ja më herët kishte bërë me dije se është kërkesë e saj dhe e BE-së që Kosova ta shtyjë afatin për reregjistrim për dhjetë muaj, duke përsëritur qëndrimin e mëhershëm se Kosova ka të drejtë në vendimin e saj.

ShBA-ja tha se Kosova ka të drejtë ta zbatojë vendimin për targa sipas marrëveshjes së Brukselit, por shtoi se “zgjatja e

afatit do të ishte në interes që të arrihej përparim në dialogun për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian”.

Çka parashihte marrëveshja e vitit 2016?

Marrëveshja e vitit 2016 mbi implementimin e asaj të 2011-s për lëvizjen e lirë parashihte se reregjistrimi i të gjitha automjeteve me targa të lëshuara nga Serbia në targa të Kosovës (“KS”/“RKS”) të niste më 15 janar 2017 dhe të zgjaste 12 muaj, “pas së cilës të dyja palët do ta rishqyrtonin çështjen me ndërmjetësimin e BE-së”.

E njëjta marrëveshje parashihte që Kosova të zgjaste vlefshmërinë e targave “KS” për pesë vjet (targa neutral), “pas së cilës të dyja palët do ta rishqyrtojnë çështjen (me ndërmjetësimin e BE-së nëse është e nevojshme)”.

Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës në vitin 2020 anuloi Udhëzimin Administrativ për reregjistrimin e automjeteve me targa KS në mënyrë që ato të mos lëshoheshin më nga shtatori i vitit 2021. Këto targa tashmë janë jashtë përdorimit në Kosovë.

Çka vendosi Qeveria e Kosovës?

Qeveria e Kosovës shpali të premtën planin për zbatimin e vendimit për targa, që parashihet të zgjasë deri më 21 prill. Megjithatë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se ky vendim nuk është shtyrje e afatit për targa. “Për tri javë, duke filluar nga data 1 nëntor deri më 21 nëntor, masa do të jetë ajo e qortimit. Pastaj, nga 21 nëntori, për dy muaj deri më 21 janar do të jetë masa e gjobitjes dhe më pastaj nga 21 janari do të kemi targa provuese për dy muaj të tjerë, pas së cilës datë, më 21

prill, nuk mund të ketë, sepse nuk mund të lejohen targa të tjera në Republikën e Kosovës”, deklaroi kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë mbledhjes së qeverisë më 28 tetor.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha më 29 tetor se vendimi i Kosovës lidhur me targa “është në përputhje me marrëveshjen e Brukselit” dhe, sipas tij, këtë e kanë “konfirmuar edhe partnerët tanë ndërkombëtarë”. Paraprakisht, vendimi i qeverisë për reregjistrimin e targave thoshte se kjo mund të bëhej deri më 31 tetor, ndërkaq politikanët serbë në Kosovë dhe Serbi paralajmëruan bllokada në veri nëse autoritetet e Prishtinës i konfiskojnë targa dhe makinat e serbëve pas kësaj date.

Besohet se afër 10 000 targa me akronime serbe KM, PZ, PR e të ngjashme qarkullojnë në veriun e Kosovës me shumicë serbe. Kosova i konsideron ilegale këto targa që lëshohen nga Serbia.



MSh-ja rekomandon të merret vakcina kundër gripit sezonal

PRISHTINË, 30 TETOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se mjekët rekomandojnë që të gjithë personat e moshës nga gjashtë muaj e tutje mund ta marrin vaksinën vjetore kundër gripit sezonal. "Njerëzit duhet ta marrin vaksinën e gripit herët për të krijuar imunitet përpara se virusi të përhapet gjerësisht

në fund të vjeshtës dhe në dimër. Personat me rrezik të lartë për komplikime serioze të gripit përfshijnë të moshuarit, fëmijët e vegjël, gratë shtatzëna, njerëzit me kushte të caktuara shëndetësore ose sistem imunitar të komprometuar", ka njoftuar MSh-ja. Disa grupe janë gjithashtu në

rrezik të lartë të komplikimeve edhe nga Covid-19. "Prandaj, u rekomandohet qytetarëve të vaksinohen kundër gripit sezonal dhe ta marrin edhe dozën përforcuese të vaksinës kundër Covid-19! Nga e hëna, 31 tetor 2022, vakcina kundër gripit kudo në Kosovë", ka njoftuar MSh-ja.



Arrestohen tre persona, sekuestrohet drogë dhe para

Antidroga e Policisë së Kosovës ka arrestuar tre persona të dyshuar si pjesë e një grupi kriminal, ku ka sekuestruar drogë, para dhe dëshmi të tjera

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 TETOR - Policia e Kosovës, konkretisht hetuesit e antidrogës nga rajoni i Prishtinës, të asistuar nga Njësi i Antidrogës në Prizren, pas hetimeve disamujore të rastit të koduar me emrin "Bardhoshi-2", më 29.10.2022, rreth orës 16:30, në autostradën Prishtinë - Prizren në fshatin Reshtan të komunës së Suharekës, kanë arritur ta ndalojnë veturën e dyshuar të tipit Mercedes, ngjyrë e zezë, me targa vendore të cilën e drejtonte i dyshuari me

iniciale (K. P.) dhe pasagjer ishte i dyshuari tjetër (D. K.). Pas kontrollit të automjetit në cilësi të provës materiale janë gjetur dhe sekuestruar: 30.3 gramë substancë e dyshuar narkotike e llojit kokainë, 768.2 gramë substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanë, dy telefona celularë, një mulli (grinder) i cili përdoret për bluarje të marijuanaës dhe të holla me vlerë 43.10 euro.

Në vazhden e hetimit të këtij rasti me urdhër të prokurorit kujdestar, nga Njësi i Rajonal i Antidrogës në Prishtinë është realizuar kontroll tjetër në

objektet e banimit dhe objektet përcjellëse të të dyshuarve në rrugën "Muharrem Fejza", rruga "Ahmet Gashi" dhe rruga "Muhamet Çame" në Prishtinë. "Në cilësi të provave materiale janë gjetur dhe sekuestruar dëshmitë si në vijim: Në rrugën 'Muharrem Fejza' në vendbanimin (shtëpinë) e të dyshuarit (D. K.) janë sekuestruar: 1525.5 gramë substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanë, një armë zjarri me gaz, një peshore digjitale dhe 160 euro para kesh të dyshuara të jenë false. Në rrugën 'Muhamet Qame' në vendbanimin (banesën) e të dyshuarit (E. H.) janë sekuestruar: 711.6 gramë substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanë, një peshore digjitale dhe një telefon celular. Në rrugën 'Ahmet Gashi', në banesën e të dyshuarit (K. P.), janë sekuestruar: 688.4 gramë substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanaë, një tabletë narkotike e dyshuar e llojit EXTASY, dy peshore digjitale, një armë e gjatë AK 47 me dy karikatorë dhe 38 fishekë, një armë e gjatë (pushkë) me 5 fishekë dhe 11 fishekë tjerë etj", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Gjatë këtij operacioni policor në cilësi të provave materiale



gjithsej janë gjetur dhe sekuestruar: (3693.7) gramë substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanë, (105.7) gramë substancë e dyshuar narkotike e llojit kokainë, (1) tabletë e dyshuar për narkotik të llojit EXTASY, (3) armë zjarri, (2) karikatorë, (54) fishekë, (1993.10) euro, (200) lekë, (30)

franga, (30) funta, (1) dollar, (3) telefona celularë, (1) veturë, (6) peshore digjitale dhe (3) mullinj (grindera).

Pas kompletimit të rastit, me vendim të prokurorit kompetent, tre personat e dyshuar janë dërguar në mbajtje për procedura të mëtejshme ligjore.



Mot i nxehtë deri në 24 gradë celsius gjatë javës që po hyjmë

PRISHTINË, 30 TETOR - Gjatë javës së fundit të muajit tetor në territorin e Kosovës do të mbizotërojë mot me temperatura të larta. Sipas Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), temperaturat maksimale të ditës në javën që po hyjmë do të lëvizin nga 20 deri 24 gradë celsius. "Fushat me presion të lartë atmosferik të cilat kanë përfshirë vendin do të vazhdojnë të mbeten të

qëndrueshme edhe përgjatë pesëditëshit të parë të muajit nëntor. Parashihen rreze me diell dhe vlera të temperaturave mbi mesataren për sezonin e stinës që jemi", ka njoftuar IHMK-ja.

Mirëpo nuk do të ndodhë njëjtë edhe në fundjavë, pasi nga dita e premte do të zbresin temperaturat e pritët të ketë edhe reshje shiu. "Të premten mot më i freskët. Temperaturat

minimale ndërmjet 4-6 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 17-19 gradë celsius. Vikendi parashihet me kushte krejtësisht të tjera meteorologjike, pasi që do të ketë rënie të temperaturave dhe reshje shiu. Do të fryjë erë e lehtë deri mesatare nga drejtimi i verilindjes dhe jugperëndimit", ka njoftuar IHMK-ja.



Buxheti i vitit 2023 do të jetë 3.2 miliardë euro

PRISHTINË, 30 TETOR - Në mbledhjen e 103-të të qeverisë është votuar Projektligji i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023. Projektbuxheti 2023 kap vlerën prej 3 miliardë e 212 milionë eurosh, 8.7 për qind apo 220 milionë euro më i shumë sesa ai i vitit 2022. "Ekonomia vendore edhe këtë vit vazhdoi trendin rritës pavarësisht prej sfidave e krizave globale, gjë që mundësoi konsolidim e financave publike dhe realizimin e objektivave qeveritare. Rritje e zhvillim ekonomik pritet edhe me buxhetin e vitit 2023, i cili është më i larti e më gjithëpërfshirësi ndonjëherë. Projektbuxheti 2023 kap vlerën prej 3 miliardë e 212 milionë eurosh, 8.7 për qind apo 220 milionë euro më shumë sesa ai i vitit 2022. Të hyrat buxhetore për 2023 pritet të jenë në vlerë prej 2 miliardë e 884 milionë

eurosh, gjë që paraqet rritje prej 18.7-përqindësh në krahasim vitin 2022", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Sipas qeverisë, projektbuxheti i vitit 2023 ka për qëllim vazhdimin e konsolidimit të rimëkëmbjes ekonomike pas përballimit me krizat e njëpasnjëshme, zbutjen e ndikimit të presioneve të larta inflacionare me origjinë nga ambienti i jashtëm në shoqërinë tonë, si dhe sigurimin e qëndrueshmërisë makro-fiskale, veçanërisht në një kontekst të ri makroekonomik global të rrethuar me pasiguri të larta.

Kryeministri Kurti ka theksuar se duke punuar maksimalisht dhe me nder, përmes ekzekutimit të këtij buxheti, do të angazhohemi për t'i avancuar të gjitha aspektet që ndikojnë në jetën e qytetarëve të republikës sonë.



Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë: Bota po përballet me krizën e parë botërore të energjetikës

PRISHTINË, 30 TETOR - Agresioni ushtarak rus në Ukrainë do të ketë efekte afatgjata në furnizimin me energji dhe tregjet. Sipas rezultateve nga një raportim i ri, prezantuar nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (IEA), thonë se bota po përballet me "krizën e parë botërore të energjisë". IEA shtoi se faturat e papërbalueshme të energjisë mbeten problem i madh, pasi janë rritur si rezultat i kufizimit të eksporteve të naftës dhe të gazit. "Me problemet e pandërprera gjeopolitike dhe ekonomike, tregjet e energjisë mbeten jashtëzakonisht të cenueshëm dhe kriza shërben si një kujtesë për brishtësinë dhe paqëndrueshmërinë e sistemit aktual botëror të energjisë. Barra më e rëndë po bie mbi familjet e varfra, ku një pjesë më e madhe e të ardhurave po shpenzohet për



energjinë", paralajmëroi IEA. Agjencia me qendër në Paris ka përllogaritur se vlera e shpenzimeve qeveritare për

t'i mbrojtur konsumatorët nga rritja e çmimeve aktualisht është 550 miliardë dollarë në shkallë botërore

dhe pritet të rritet akoma më tej, veçanërisht në Britani të Madhe dhe në Gjermani. Raporti përmendi gjithashtu

skemën REPowerEU, e cila synon ta arrijë pavarësinë e vendeve të Bashkimit Evropian nga energjia ruse deri në vitin 2030. Agjencia parashikon që pjesa relative e Rusisë në tregtinë botërore të energjisë do të bjerë nga 20 për qind që është aktualisht në 13 për qind deri në vitin 2030.

Po ashtu, thuhet se parashikimet e bazuara te çmimet aktuale dhe politikat e qeverive tregojnë se kërkesa botërore për çdo lëndë djegëse fosile ose do të rritet ose do të qëndrojë në të njëjtat nivele.

Në fund raporti thekson se për t'i arritur emetimet neto zero deri në vitin 2050, investimet për energjinë e pastër do të duhet të jenë mbi 4 trilionë dollarë deri në vitin 2030. Në nivelet aktuale parashikohet se do të arrihet vetëm gjysma e kësaj shifre.

Rritja e çmimeve vazhdon t'i shqetësojë gjermanët

PRISHTINË, 30 TETOR - Rritja e mprehtë e çmimeve në pothuajse të gjithë sektorët është në krye të shqetësimeve të qytetarëve në Gjermani. Sipas një sondazhi, përveç luftës në Ukrainë dhe pandemisë Covid-19, inflacioni vazhdon të jetë shqetësimi kryesor. "Edhe lufta në Ukrainë, ndryshimet klimatike dhe pandemia Covid-19 nuk ishin aq shqetësuese sa rritja e kostos së jetesës", thuhet


në sondazhin e publikuar nga eksperti i konsulencës së menaxhimit McKinsey, Marcus Jacob. Rreth 57 për qind e më shumë se 1 000 të anketuarve thanë se shqetësimi i tyre më i madh për momentin ishte inflacioni. Më shumë se dy të tretat e të anketuarve, në sondazhin e kryer midis 23 shtatorit dhe 2 tetorit, thanë se prisnin që çmimet të vazhdonin të rriteshin.

Ndërsa vetëm 18 për qind e të anketuarve e quajtën luftën në Ukrainë si shqetësimin e tyre më të madh, 6 për qind ishin të shqetësuar për ndryshimet klimatike dhe 3 për qind për Covid-19.

Sipas Jacob, më shumë se një e treta e konsumatorëve tashmë duhet ta kufizojnë konsumin e produkteve jothelbësore. Më shumë se gjysma e tyre nuk po kursejnë më.



Ana magjike e njeriut



Aurora borealis. Rrufeja sferike. Një yll kometë. Shiu pas një thatësire të gjatë. Gjahtarë që mendojnë se janë të padukshëm. Shërime me psalme “magjike”. Një formulë në një sarkofag që ndihmon të vdekurin të zgjohet në botën e përtejme. Të gjitha situata që bëjnë pjesë në botën e magjisë, lindur si magjepsje, frikë, përpara të panjohurës dhe fenomeneve spektakolare dhe në dukje mrekulli të natyrës, tentativë njerëzore për të ndryshuar forcat natyrore në fushë dhe të ardhmen e njerëzve. Një vizion sigurisht jo shkencor (edhe pse do të ketë një rol në lindjen e shkencës), por gjithësesi gjithmonë një mënyrë për të reaguar, për të mos iu nënshtuar në mënyrë pasive botës së jashtme.

Kurë në mendje

Magjia ka shërbyer shpesh herë, në mos për të shpjeguar apo kontrolluar natyrën, të paktën për të zbutur ankthin përballë fenomeneve sociale dhe natyrore vështirësisht të menaxhueshëm dhe kuptueshëm. Është një mënyrë për të parë. Është një mënyrë për të parë realitetin e zakonshëm për të gjithë njerëzimin. “Edhe pse në shumë kultura vetë termi nuk ekziston”, shpjegon Profesor Attilio Mastrocinque, historian në universitetin e Udines, “aspektet magjike janë të integruar zakonisht

në ritet fetarë, në kurat shëruese të vendasve. Në themel mes vizionit magjik dhe atij fetar ka shumë afërsi. Jo më kot shpesh herë përcaktojmë si “magji” ritet dhe besimet në mrekullitë që karakterizojnë besimet e të tjerëve”. Magjia ka patur për shumë kohë një funksion praktik. Në lashtësi ishte e bashkuar me shkencën. “Koncepti i magjisë, në sensin negativ, vjen nga grekët. Më pas u mor nga romakët, nga krishtërimi dhe nga iluminizmi francez”, shpjegon Mastrocinque. “Magjia në fakt është një fjalë me origjinë greke: “mag-ët” ishin priftërinj persë të Zoroastros, ekspertë në parashikimin e të ardhmes me anë të yjeve. Përveçse një mënyrë për të parë realitetin, magjia përgjatë historisë është konkretizuar në një pafundësi ritesh, praktikash, besimesh dhe metodash një pjesë e të cilave janë shumë të përhapura edhe sot. Sot magjia mund të jetë “e bardhë”, kur përdoret për t’i bërë mirë dikujt ose “e zezë”, nëse qëllimi është të dëmtojë. Është tentativa për të transformuar gjërat dhe ngjarjet duke përdorur energji të supozuara, në forma të ndryshme. Magjia “e kontaktit” përdor ilaçe magjike dhe filtra. Ajo e “mallkimit” përdor fjalë dhe formula. “Simpatikja” pamje dhe objekte (kukulla etj) që përfaqësojnë personin që duhet mbrojtur apo dëmtuar. Hyjnizimi është një tjetër formë e magjisë. Në fund është

magjia e “ngjashmërisë”: imitohet një kafshë për të favorizuar gjahun.

Kafshë-shpirtëra

Ritualet magjike kanë ekzistuar që mijëra vjet më parë. Përshembull, pikturat në mure të Lascaux në Francë apo të Altamiras në Spanjë shfaqin kafshë – shpirtëra të pikturuara nga shamanë në gjendje trance dhe më pas të riprodhuara po nga ata vetë për të nxitur gjahun. Në qytetërimet e parë, ishte e përhapur bindja magjike që përmes yjeve mund të parashikohej e ardhmja. E zhvilluan fillimisht Sumerët dhe më pas Babilonianët, ekspertë si persët. Gjithmonë në Mesopotami, përdorshin varëse për të neutralizuar demonët dhe fjalë magjike për të kontrolluar shpirtërat. Magjistari, për t’u mbrojtur nga forcat negative, bënte një rreth brenda të cilit operonte. Në Egjipt, magjia ishte e lidhur me botën e përtejme. Libri i të vdeurve që përmbledh përshkrimet e formulave të shkruajtura në sarkofagë dhe mure të varreve egjiptiane ishte quajtur fillimisht Fjalë magjike për daljen e shpirtit drejt dritës së plotë të ditës. Për egjiptianët, kur një varr ishte i mbyllur, figura dhe objekte si statuja shërbëtorësh, fshatarë, varka dhe karroca, bëheshin me shpirt. Në disa raste të afërmit hiqnin piktogramët e gjarpërinjve

nga hieroglifet për të mos lejuar që ai që ishte në varr të dilte “i vdekur”.

Në luftë me arsyen


Edhe në Greqinë e lashtë ishte e përhapur magjia, por u zhvillua edhe një formë që i kundërvijej asaj. Për shembull Hipokrati, mjeku që jetoi në periudhën mes shekujve V dhe IV para Krishtit i kritikonte magjistarët sharlatanë. “Që në shekullin VI para Krishtit”, thotë Mastrocinque “zhvilloheshin procese penale kundër grave që përdornin ilaçe magjike për të manipuluar burrat e tyre”. Dyshimi se ka përdorur magjinë ekziston edhe për Jezusin. Në bazë të gjetjes së një dorëshkrimi të lashtë në malin Athos në Greqi, pastori protestant Smith Morton, autor i librit Jezusi Magjistar ka hedhur hipotezën që Mesia ka përdorur teknika të magjisë të përfuara nga sekta hebraik e Essenëve.

Procese politike

Në Romë, në shekullin V para Krishtit kishte ligje kundër incantamenta-ve, formula që këndoheshin për të lehtësuar vjedhjet e grabitjet. Diktatori Lucio Cornelio Silla (shekulli II para Krishtit) nxorri një ligj kundër helmimeve. “Perandori August (shekulli I para Krishtit)”, thotë Mastrocinque “e ndaloi astrologjinë, e konsideruar

praktikë që duhej zhdukur: parashikimi i të ardhmes interferonte me politikën. Ata që kapeshin, persekutoheshin”. Kishte dënime të skllëvërve që akuzoheshin se i mbanin nën grusht padronët përmes praktikave magjike. Diokleciani, në vitin 285 nxorri një ligj kundër magjisë, përveç asaj agrare dhe mjekësore. Të krishterët gnostikë akuzoheshin sepse studionin Zoroastrën dhe orakujt persë. Pavarësisht represionit nuk pushuan lajmet për hyjnizime, talismanë, vrasje në distancë, statuja folëse etj. Magjia u rikthye në modë në kulmin e Humanizmit, atëherë kur filozofi Marsilio Ficino përktheu Corpus Hermeticum të orakujve kaldaikë dhe të himneve orfikë, grup veprash që i atribuoheshin Zoroastrës, Orfeut dhe Hermes Trimegistos (figurë që bashkoi dijet e perëndisë greke Hermes me ato të atij egjiptian Toth). Agrippa von Nettescheim, mjek, filozof dhe alkimist gjerman, Giovanni Battista della Porta dhe alkimisti Paracelso i konsideronin të afërta shkencën eksperimentuese dhe magjinë. Nxjerrja e floririt nga hekuri, manipulimi i materies ishin shpresat e asaj kohe. Edhe arabët e përhapën magjinë me vepra si Picatrix, e njohur që në shekullin XI. Por në shekullin XVII, para Iluminizmit, nisi edhe rënia e magjisë në botën perëndimore. / Bota.al





EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Besa pëson për një gol, kualifikimin e kërkon në Pejë

PEJË, 30 TETOR - Besa Famgas e ka humbur ndeshjen e parë të raundit të dytë të Kupës Evropiane. Në Helsinki të dielën, kampionia kosovare humbi me rezultatin e ngushtë, 28:27 nga skuadra IFK Handball Helsinki. Besa

ishite duke udhëhequr pas pjesës së parë, 13:12, por vendasit shfaqën më shumë në pjesën e dytë. Kështu vendimtare do të jetë ndeshja e kthimit që luhet pas një jave në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Te Besa Famgas janë të vendosur për

të kaluar në raundin e tretë. Pejanët e nisën ndeshjen mirë dhe krijuan epërsi deri në pesë gola në pjesën e parë. Në pjesën e dytë rezultati ishte kryesisht i barabartë, por vendasit ishin më shumë në epërsi. Krijuan epërsi deri në katër

gola, por Besa u afrua në vetëm një gol në fund, 28:27. Egzon Gjuka i shënoi 8 gola nga 14 tentime. 5 gola nga 5 tentime i shënoi Jon Vokshi, kurse Victor Alonso realizoi 5 gola nga 7 tentime. Ivan Mariq i shënoi 4 gola nga 8 tentime. Arti



Luzha i kishte 8 pritje, kurse Flakrim Beqiraj i kishte 4 pritje.

Peja nuk njuh humbje, Ylli shijon fitoren e katërt radhazi

PRISHTINË, 30 TETOR - Peja ka regjistruar fitoren e tetë këtë edicion, duke qenë skuadra e vetme pa humbje në elitë. Vedhezinjtë kanë mundur Sigal Prishtinën 79:77 (18:23, 26:17, 20:20, 15:17), në klasiken kosovare, ndërsa prishtinasit kanë pesë fitore e tri humbje. Prishtinasit e nisën ndeshjen shumë më mirë, duke krijuar epërsi prej tetë pikësh, 6:14, dhe gjatë gjithë çerekut të parë ishin në epërsi, ku e fituan këtë pjesë 18:23. Por, pejanët nuk u dorëzuan dhe me një seri fantastike barazuan shifrat në 33:33, dhe kthyen epërsinë në të mirë të tyre, 41:33, ndërsa skuadrat shkuan në pushim me rezultat 44:40. Periudha e tretë ishte interesante dhe e barabartë.

Vendasit u mundonin të shpëputeshin në rezultat dhe mysafirët që afronin shifrat, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 64:60, gjithnjë për vedhezinjtë. Lojë dramatike u zhvillua në dhjetë minutat e fundit, ku pejanët sërish u shpëputën, megjithatë kryeqytetasit afrojnë rezultatin në 78:77, madje kishin rastin edhe të fitojnë kur Rrezart Memedi nuk shënoi dhe rezultati përfundimtar ishte 79:77. Te Peja u dalluan Brad Waldow me 12 pikë e 12 kërcime dhe Rodney Purvis me 20 pikë, kurse te Sigal Prishtina më të mirët ishin Dustin Thomas me 21 pikë e 11 kërcime, Derrick Wilson me 14 pikë dhe Dardan Berisha me 13 pikë e nëntë asistime. Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore



bindëse ndaj Rahovecit me shifrat 109:59 (19:11, 35:10, 27:18, 28:20), në xhiron e tetë të Prince Caffè Superligës. Kjo ishte fitorja e katërt radhazi për kampionët e Kosovës, ndërsa humbja e shtatë radhazi për "Vreshtarët", që fitoren e

vetme e kanë pikërisht ndaj therandasve. Ylli dominoi nga fillimi deri në fund, duke shënuar fitore të merituar dhe më bindësen në këtë edicion. Vendasit e nisën më mirë ndeshjen, ku qysh në fillim kishin

shtatë pikë epërsi, 12:5, ndërsa gjatë gjithë çerekut të parë ishin në epërsi, duke e fituar këtë pjesë 19:11. Dallimi më i madh dhe vendimtare u bë në periudhën e dytë. Therandasit ishin të jashtëzakonshëm në këtë pjesë, duke rritur epërsinë minutë pas minute, ndërsa shkuan në pushim me epërsi të thellë, 54:21. Kampioni i Kosovës dominoi edhe në pjesën e dytë, që nuk kishte shumë histori dhe triumfuan bindshëm me 50 pikë dallim, 109:59. Te Ylli u dalluan Rashun Davis me 21 pikë e tetë asistime, Henrik Sirko me 20 pikë e pesë asistime dhe Bashir Ahmed me 18 pikë e dhjetë kërcime, kurse te Rahoveci më i miri ishte Jahi Carson me 18 pikë, pesë kërcime e gjashtë asistime.

Llapi bindës ndaj Dritës, Gjilani fiton me supergolin e Ramadanit



PODUJEVË, 30 TETOR - Skuadra e Llapit ka shënuar fitore bindëse në duel me skuadrën kryesuese në renditje, Dritën, në kuadër të javës së 14-të në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë është mbyllur me rezultat 4:1. Të gjithë golat e këtij ballafaqimi janë shënuar në pjesën e parë. Drilon Fazliu i zhbllkoi shifrat e ndeshjes në minutën e 9-të. Mysafirët barazuan rezultatin në minutën e 17-të përmes Marko Simonovskit. Megjithatë llapjanët

shumë shpejt e rikthyen epërsinë me golin e Bianor Netos (25'), për ta vulosur më pas fitoren me dy gola tjerë të realizuar nga Kushtrim Shabani (38') dhe Francisco Riviera (43'). Për skuadrën e Tahir Batatinës kjo fitore erdhi pas dy humbjeve radhazi dhe një barazimi. Tani Llapi është ngritur në vendin e gjashtë me 16 pikë, derisa Drita mbetet lidere me 30 pikë. Fitore para tifozëve të vet ka regjistruar edhe Gjilani, që e mposhti Dukagjinin, me shifrat 1:0. Për fitoren e skuadrës së Zekirija

Ramadanit u përkujdes Arbnor Ramadani, i cili realizoi një supergol nga distanca, në pjesën e dytë. Pas kësaj fitoreje Gjilani zë vendin e tretë me 23 pikë, ndërsa Dukagjini renditet i teti me 12 pikë. Të shtunën janë zhvilluar dy ndeshjet e tjera të kësaj jave, ku Malisheva realizoi fitore ndaj Trepçës'89, me rezultat 4:0, derisa Ferizaj dhe Drenica luajtën baras 1:1. Ndeshja ndërmjet Ballkanit dhe Prishtinës është shtyrë për shkak të angazhimeve të skuadrës suharekase në UEFA Conference League.

Rahoveci debuton me humbje në Evropë

RAHOVEC, 30 TETOR - Rahoveci e ka luajtur ndeshjen e parë evropiane. Të dielën mbrëma në palestrën "Mizahir Isma", Rahoveci e priti kampionin e Çekisë, HCB Karvina. Ndonëse pa përvojë ndërkombëtare, "vreshtarët" janë mbajtur deri

në fund me Karvinan, skuadrën me shumë përvojë në garat evropiane. Karvina fitoi me katër gola dallim, 33:29, por paraqitja e Rahovecit duhet vlerësuar. Lojtarët e Rahovecit nuk janë dorëzuar deri në fund dhe vazhdimisht

kanë kërkuar të afrohen në rezultat. Pas pjesës së parë rezultati ishte 17:13 në të mirë të skuadrës çeke. Braziliani De Carvalho Fernandes ishte më efikas te Rahoveci. Ai i shënoi 7 gola nga 14 tentime. Besmir Kusari i kishte 6 gola nga 7

tentime, kurse Alban Haziri i kishte 5 gola nga 8 tentime. Arbër Curri i kishte 6 pritje. Matej Nanti i shënoi 5 gola për Karvinan, kurse tre lojtarë i shënuan nga 4 gola. Ndeshja e kthimit është pas një jave në Çeki.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Sun Energy ShSXh" Sh.p.k Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e impiantit fotovoltaik me kapacitet 8.0 MW në Svinjarë (Frashër) komuna e Mitrovicës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 25.11.2022 në ora 11:00 në hapësirat "HOTEL PALACE&SPA" Salla e takimeve, Shupkofc, komuna e Mitrovicës do të organizohet debat publik nga Kompania "Sun Energy ShSXh" Sh.p.k Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e impiantit fotovoltaik me kapacitet 8.0 MW në Svinjarë (Frashër) komuna e Mitrovicës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphaD1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Sun Energy ShSXh" Sh.p.k Mitrovicë për ndërtimin e impiantit fotovoltaik me kapacitet 8.0 MW në Svinjarë (Frashër) komuna e Mitrovicës.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nami Sadik Mulaj-komuna Klinë, shpall të pavlefshme Diplomën e SH.M. "Nikola Tesla".

- Hatixhe Hertica nga Prishtina, shpall të pavlefshme Diplomën e SH.M. "Sami Frashëri" viti 05.06.2003.

- Gjon Zholi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.

- Pranvera Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Admir Zurnaxhiu shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

